

LIGJ
Nr.8344, datë 13.5.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7805, DATË 16.3.1994 "PËR TATIMIN MBI PASURINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7930, DATË 11.5.1995

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 "Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7930, datë 11.5.1995, neni 6 ndryshohet si vijon:

"Të ardhurat e realizuara nga tatimi mbi pasurine i kalojnë 100 për qind buxhetit të pavarur të pushtetit lokal."

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si vijon:

"Ministria e Pushtetit Lokal ngarkohet me zbatimin dhe administrimin e mbledhjes së tatimit mbi pasurinë, pranë të cilës kalojnë strukturat përkatës.

Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit detyrohen të vënë në dispozicion të Ministrisë së Pushtetit Lokal gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do t'u kërkohej për zbatimin e këtij ligji."

Neni 3

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. "

Neni 4

Nenet 3 dhe 5 të ligjit nr.7930, datë 11.5.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 "Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë"", shfuqizohen.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit të tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2095, datë 18.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani